



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 232, Datë 30.10.2024**

**MBI**

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN  
E SHOQËRISË “DRIBEN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/8 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “DRIBEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 03.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 12.09.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k., për arsye se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Pas kryerjes së pagesës së aplikimit brenda afateve të përcaktuara në rregullore, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 203, datë 27.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.10.2024 dhe 02.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057 prot., datë 08.10.2024, ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.
- Me shkresën nr. 1857/6 prot., datë 04.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar të plotësojë informacionin /dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857/7 prot., datë 11.10.2024, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit dhe rezulton se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, me qëllim marrjen e kohës së nevojshme për zhvillimin e një korrespondence vijuese në lidhje me dokumentacionin e përcjellë nga shoqëria për të saktësuar dokumentacionin financiar (përcjelljen e planit të biznesit të azhornuar), sqaruar mbështetjen financiare dhe informacionin në lidhje me fillimin e punimeve, vlerësojmë të zgjatet deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë sa konstatuar më sipër brenda 5 (pesë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar brenda 5 (pesë) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DRIBEN sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**